



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/23/21;
Datë: 06.09.2021 .

Në bazë të nenit 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.08.2021 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të
Planit Trevjeçar të banimit

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i programit tre (3) vjeçare të banimit për popullsinë e Komunës së Junikut/në tekstin e mëtejme Planit/.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të Planit, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të programit tre (3) vjeçare të banimit për popullsinë e Komunës së Junikut

III. Bartëse e hartimit të Planit nga pika I. e këtij vendimi është Drjertorija për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis.

IV. Bartësja e hartimit të Planit është e obliguar që Planin ta hartojë në afat prej 2 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V. **Plani** duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

VI. Pas hartimit, **Plani** i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

VII. Mjetet financiare për hartimin e Planit sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm , Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem KRASNIQI

kryesues

